



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:297288

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06608045

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm,- Divizioni Civil, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me bashkëpunëtorin profesionale Ismail Kuçi, në çështjen juridike kontestimore te paditësit N. I. , nga fshati ...Komuna Kaçanik, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati A. R., rruga “...” (Ganirosha- objekti 3) L-No.08/Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Kaçanikut, në çështjen kontestuse pagesa e pagave për përcjellje në pension, jashtë seancës gjyqësore më datën 17.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N. I. nga fshati ...dhe DETYROHET e paditura Komuna e Kaçanikut, që paditëses t’ia paguaj shumën prej (3 x 941.00€), në shumë të përgjithshme prej 2,823.00 €, në emër të tri pagave për përcjellje në pension. Këtë shumë me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 31.12.2021(data e paraqitjes së padisë), e deri ne pagesën përfundimtare.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Kaçanikut, që paditësit, t’ia paguaj shumën si ne pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 40,00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarit , me datën 30.12.2021, në gjykatë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Kaçanikut, që paditëses t’ia paguaj shumën prej (3 x 941.00€), në shumë të përgjithshme prej 2,823.00 €, në emër të tri pagave për

përcjellje në pension. Këtë shumë e ka kërkuar me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 31.12.2021, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Paditësi ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës Mjek Stomatolog deri më datën 01.09.2021, ku sipas fuqisë ligjore, i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit. E paditura edhe pse ka pasur për detyrim që paditësit të ja paguaj këtë shumë nuk ja ka paguar. I padituri tek e paditura ka punuar gjithsejtë 26 vite, deri në pensionim dhe i plotëson kriteret e parapara me neni 17 paragrafi 5, të Kontratës Kolektive Sektoriale, Nr. 05-3815, e lidhur në mesë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatave të Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, për kompensimin e tri pagave për përcjelljen në pension. Prandaj nga këto baza, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratojë në tersi si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata duke vepruar në bazë të neneve 394, 395 dhe 396 të LPK-së, me datën 14.09.2022, e ka nxjerr aktvendimin, me të cilin e ka detyruar të paditurën, që të paraqes përgjigje në padi, të deklarojë se a e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata me datën 21.09.2022, palës së paditurit i ka dorëzuar padinë, me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi.

E paditura, më datën 30.09.2022, ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar. Duke shtuar se nënshkruar të Kontratës Kolektive Sektoriale, të datës 11.06.2018, është Ministria e Shëndetësisë në njërin anë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në anën tjetër. Tutje ka theksuar meqenëse Komuna e Kaçanikut, nuk e ka nënshkruar këtë kontratë nuk ka obligim që ta paguaj, po ashtu nuk ka mundësi buxhetore të bëjë mbulimin e këtyre shpenzimeve, prandaj i ka bere kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës që të ndërhyjë si palë nënshkruese e kësaj Kontrate për të siguruar mjetet e nevojshme.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimet e tyre për ti parashtruar ato si dhe duke u bazuar në nenin 7.1

të LPK-së, ka administruar këto prova edhe atë: përgjigja e datës 26.04.2019, përgjigja në kërkesë, e datës 12.04.2019, vendimi i datës 31.08.2021, vërtetimi i datës 06.09.2021 dhe përgjigja në padi.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të së cilës veç e veç, si dhe të ndërlidhura si tërësi në mes veti, mbi bazën e bindjes se lirë, në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së. Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 02.12.1986, e deri më datën 02.09.2021. Paditësi ka 26 vite të përvojës së punës dhe e paditura nuk ja ka paguar tri paga për përcjellje në pension. Me hyrjen në fuqi të kontratës kolektive sektoriale më datën 11.06.2018, paditëses i takon e drejta në shpërblimin jubilarë.

a) Se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune, tek e paditura, që nga data 02.12.1986, e deri më datën 01.09.2021 këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga vërtetimi numër 246, i datës 06.09.2021, i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Kaçanik, ku është shënuar se N. I. Stomatolog, ka qen i punësuar nga data 02.12.1986 e deri me datën 01.09.2011, kurë është pensionuar. Po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të provave tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky fakt nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse.

b) Se paditësi ka përvojë pune 26 vite, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga thëniet në padi, vendimi i datës 31.08.2021, vërtetimi i të paditurës, nga të cilat prova vërtetohet se i njëjti ka përvojë pune 26 vite, ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse

c) E paditura, nuk e ka kryer detyrimin ligjorë, të marrë me kontratën kolektive dhe paditëses nuk ia ka paguar 3 paga për përcjellje në pension, ashtu siç është paraparë me kontratën kolektive sektoriale, të datës 11.06.2018. Këtë fat gjykata e ka vërtetuar nga thëniet në padi, theksimet me përgjigje në padi nga e paditura, e cila ka theksuar se këtë pagesë nuk e kemi bërë për shkak të mungesës së mjeteve monetare, dhe ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërhyjë si palë nënshkruese e kësaj kontrate për ti siguruar mjetet e nevojshme monetare.

d) Se paditëses i takon e drejta në shpërblim e tri pagave për përcjellje në pension, në vlerën e pagës se fundit të realizuar tek punëdhënësi. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat

te cilat gjenden ne shkresat e lëndës. . Po ashtu kjo e drejte i takon ne baze te kontratës kolektive Sektoriale te datës 12.06.2021 edhe atë konfrom neni 17 paragrafi 5 i kësaj kontrate. Me këtë dispozitë është paraparë kompensimi në rast të pensionimit , i punësuari me rastin e pensionimit , gëzon të drejtën në pagesën në lartësi prej 3 pagave mujore, që i ka marrë për tre muajt e fundit.

Gjykata sa i përket shumës së kërkuar, lartësinë e sajë e ka vërtetuar nga lista e pagave, nga e cila e ka vërtetuar se paga e fundit e paditëses ka qenë në vlerë prej 941.00 € dhe për tri paga për përcjellje në pension i takon shuma e përgjithshme prej 2, 823,00 €.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës në pozitën Stomatolog tek e paditura, respektivisht në QKMF-“Dëshmorët e Lirisë” në Kaçanik, ky fakt u vërtetua nga vendimi numër 238 dhe vërtetimi i datës 01.09.2021, me numër 246, të lëshuar nga e paditura.

Gjykata Vendimin dhe Vërtetimin mbi përvojën e punës, i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Prandaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura, brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që me Vërtetimin mbi përvojën e punës, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjë të cilën as e paditura nuk e ka kundërshtuar përmes përgjigjes në padi, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata bazuar në provat e lartcekura, e veçanërisht vërtetimi i datës 06.09.2021, i lëshuar nga e paditura, gjen se në rastin konkret zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale (më tej KKS) në Kosovë, e miratuar dhe e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj për periudhë tri vjeçare).

Me nenin 17 par, 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale, është paraparë kompensimi në rast të pensionimit , i punësuari me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën në lartësi prej 3 pagave mujore, që i ka marrë për tre muajt e fundit.

Në paragrafin 4 të nenit 17 të KKS, është paraparë që “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”. Sipas këtyre dispozitave të Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë, dhe ky shpërblim paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf. Në rrethanat e tilla faktike gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si punëtore e sektorit shëndetësor t’ia paguaj tri page në emër të shpërblimit jubilar sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 17 të KKS.

Prandaj gjykata e miratoi kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në nenin 35 pika 5 të Kontratës kolektive Nr.24, te datës 18.04.2017, si dhe duke u bazuar në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës GJ.A. 214/2023, i datës 05.10.2023.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Po qe se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.*” Edhe me dispozitën e nenit 398 të LPK-se, parashihet shprehimisht se gjykata mund të jap aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes nëse pas marrjes së përgjigjes në padi, konstaton se në mes të palëve nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante. Meqenëse janë plotësuar kushtet edhe atë: e paditura është përgjigjur në padi pastaj pala e paditur ka theksuar se nuk ka mjete për të paguar këtë detyrim nuk e ka pohuar e as mohuar kërkesëpadinë e paditësit dhe nuk ekziston pengesa tjera për dhënien e këtij aktgjykimi.

Prandaj, bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë dhe atë duke u bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive , ndërsa shumica e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata me rastin e vendosjes ka marre për baze nenin 10 par.1 të LPK-së, me këtë dispozite është paraparë se “ ne rast te fillimit te procedurës gjyqësore civile atëherë është obligim i gjykatës por edhe i palëve qe procesi te zhvillohet ne mënyrë sa me efikase dhe me shpenzime sa me te vogla qe është menduar”. Pra, qëllimi i kësaj dispozite është qe procesi te jete efikas i shpejte dhe i lire. Ky detyrim se pari i takon gjykatës dhe pastaj palëve pjesëmarrëse ne këtë proces.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës se palës paditëse e ka caktuar edhe kamatën duke u bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e paraqitjes se padisë pra nga data 31.12.2021, e deri ne pagesën definitive. Këtë kamat e ka caktuar duke u bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020.

Gjykata i analizoi pretendimet e palës paditëse, e cila ka kërkuara nga gjykata qe kërkesëpadia të miratohet në tersi si e bazuar, këtyre theksimeve gjykata u a dha besimin, sepse kjo e drejt i takon paditësit me nenin 35 pika 5 të , të Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë, e miratuar dhe e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e të paditurës të paraqitura me përgjigje në padi, e cila i ka propozuar gjykatës qe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tersi si të pa bazuar. Këto pretendime gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse kjo e drejt i takon paditësit me nenin 35 pika 5 të , të Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë, e miratuar dhe e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.20, si dhe lidhur me neni 90 të Ligjit të punës.

Gjykata e detyroi palën e paditur qe paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore ne shume prej 40.00€, ne emër te taksës për padi. Gjykata vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar ne nenin 451.1 te LPK-se, ndërsa taksen gjyqësore e ka caktuar konform udhëzimit administrativ 01/2017 te KGJK-se.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

Dega Kaçanik

2021:297289, prej datës 17.12.2024

Gjyqtari

Riza Livoreka

KESHILLA JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, ne kopje te mjaftueshme.

Dërguar me datën 17.12.2024

Paditësit 1x1

Të paditurit 1x1.

Numri i lëndës: 2021:297288
Datë: 17.12.2024
Numri i dokumentit: 06608045